

**Zgjedhjet më
17 nëntor 2007**



**Zhvillimi i shërbimeve elektronike për
qytetarët e Kosovës**

Zgjedhjet më 17 nëntor 2007



Më 17 nëntor 2007, Kosova do të dalë në votime. Në konsultim me partitë politike dhe Ekipin e Unitetit, PSSP-ja ka definuar kornizën ligjore dhe përcaktuar datën për mbajtjen e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, kuvendet komunale dhe kryetarët e komunave.

Zgjedhjet do të zhvillohen me sistem me listë të hapur, ashtu edhe siç u prit dhe u dëshirua nga shumica. Njerëzit do të vendosin se cilët kandidatë do të zënë pozita në Kuvend bazuar në numrin e votave që fitojnë. Do të aplikohet pragu zgjedhor prej

5 % për partitë që vijnë nga komuniteti shumicë, duke mbajtur 30% kuotën gjinore për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Një risi tjetër do të jetë zgjedhja e drejtpërdrejtë e kryetarëve të komunave, në rast nevojë edhe në balotazh në rundin e dytë.

Gjatë muajve të ardhshëm mund të presim një periudhë intensive të fushatave politike, para periudhës më të ndjeshme të definimit të statusit të Kosovës. Treshja ndërmjetësuese nga SHBA, BE dhe Rusia, e përzgjedhur nga Grupi i Kontaktit, është duke konsultuar përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë dhe pritet që dorëzojë raportin e vet Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve Ban Ki-Mun më 10 dhjetor 2007.

Duke qenë që procesi për definimin e statusit të Kosovës nuk do të pengohet nga mbajtja e zgjedhjeve, këto zgjedhje do të mbahen dhe kësaj do të përtërihet mandati i institucioneve demokratike të Kosovës.

Meqë edhe mandati i dytë (2004-2007) i Kuvendit është duke përfunduar, mund të flitet edhe të vlerësohet progresi i arritur dhe fuqia e tij institucionale: Komisionet parlamentare janë më mirë të organizuara dhe kanë mbajtur më shumë dëgjime publike; deputetët kanë përmirësuar mbikëqyrjen ndaj qeverisë, veçanërisht përmes numrit më të madh të pyetjeve parlamentare të parashtruara; ndërkohë që edhe menaxhimi i brendshëm i Kuvendit është më efikas. Kuvendi vazhdon të shënojë progres edhe në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve.

Ky edicion i Buletinit të ASI-t përmban një intervistë me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, z. Haki Shatrin, i cili flet mbi sfidat e procesit buxhetor për vitin 2008. Në një intervistë tjetër, Genc Gorani, deputet i Kuvendit, flet për shfrytëzimin e Teknologjisë Informative të Komunikimit në sektorin publik dhe ndikimin që ushtron tek qytetarët. Misioni i OSBE-së ka lëshuar raportin e vet të 50-të të monitorimit, i cili trajton çështjet që duhet adresuar për të fuqizuar edhe më punën e Kuvendit.

Me këtë rast, dëshirojmë që të falënderojmë të gjithë ata që kontribuuan për Buletinin gjatë këtij mandati të dytë të Kuvendit, dhe ju ftojmë të dërgoni komentet dhe mendimet e juaja për edicionet e ardhshme.

Franklin De Vrieze,

Koordinator i Iniciativës për Mbështetje Kuvendit

Zgjedhjet më 17 nëntor 2007	2
Zhvillimi i shërbimeve elektronike për qytetarët e Kosovës	3
Një mënyrë alternative për të përfunduar procesin e statusit të Kosovës	4
Koha për të reflektuar	6
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2008: Info mbi Qarkoren Buxhetore dhe Sfidat	8
OSBE-ja publikon raportin e saj të pesëdhjetë mbi punën e Kuvendit	10
Deputeti duhet të jetë deputet!?	11
Nevojitet të tregohet pjekuri	12
Raporti i Zhvillimit Njerëzor – më afër njerëzve	14
Mirëseardhje për Karlo Binda, Drejtor i Institutit Kombëtar Demokratik –“NDI”	15
Deputetët e Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s	16
Kuvendi i Kosovës- nga këndvështrimi i deputetëve	17
Forcimi i kapaciteteve për krijimin e një procesi sistematik dhe të koordinuar të hartimit legjislativ	18
Përvoja ime për gjysmë viti në Kuvendin e Kosovës	19



Zhvillimi i shërbimeve elektronike për qytetarët e Kosovës: Politikat e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) në Kosovë

Intervistë me Z. Genc Gorani, anëtar i delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Estoni

Nga 10 deri më 17 qershor 2007, një delegacion nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, i përbërë nga anëtarë të Kuvendit, teknikë të TI-së dhe zyrtarë të lartë qeveritarë, ishin për një vizitë studimore në Estoni. Synimi i vizitës ishte të mësohej për shfrytëzimin e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) në sektorin publik në Estoni. Vizita u organizua nga Ministria e Jashtme e Estonisë, zbatuar nga Akademia e E-Qeverisjes, si dhe mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

ASI: Z. Gorani, ju ishit pjesë e delegacionit që vizitoi Estoninë për të mësuar mbi politikën e TIK-ut. Cilat janë shërbimet e TIK-ut që i ofrohen qytetarëve të Estonisë?

Genc Gorani: TKI (ICT) shërbimet ('shërbimet elektronike') për qytetarët në Estoni janë të shumta dhe mbulojnë një pjesë të madhe të shërbimeve publike. Vlen të përmenden këto shërbime me qasje direkte nga qytetarët: konsultimi dhe dhënia e certifikatave nga një numër i madh të regjistrave administrativ, sikur janë regjistrat civil, pronësor (kadastral dhe urbanistik), regjistrat nga sistemi arsimor, shëndetësor dhe social. Në veçanti do ta theksoja ekzistencën e "shërbimit elektronik të noterisë" i cili është i ndërlidhur me zinxhirin e plotë të transaksioneve pronësore. Poashtu, qytetarëve në Estoni u është mundësuar t'i kryejnë deklari-



met dhe pagesave të tatimeve nëpërmjet të kompjuterit dhe internetit nga cilido vend – pa humbur kohë, me kosto minimale dhe efikasitet administrativ. Administrata e tatimeve në Estoni u përgjigjet qytetarëve brenda vetëm 5 ditësh me saldon e tatimeve. Kuptohet se pse në Estoni 95% e qytetarëve i kryen obligimet tatimore në këtë mënyrë.

ASI: Cilat nga këto shërbime mund të ofrohen në Kosovë?

GG: Sot për sot, praktikisht asnjë prej këtyre shërbimeve elektronike nuk u ofrohen qytetarëve dhe bizneseve në Kosovë. Shumë pak është bërë në këtë domen të administratave Kosovare. Nga ana tjetër, për t'i realizuar këto, investimet e duhura janë mjaft modeste në krahasim me efektin e madh në mirëqenien e qytetarëve dhe efikasitetin e administratave. Këtë e mendoj në veçanti për shërbimet që kanë të bëjnë me regjistrat civilë që janë më të kërkuarit nga qytetarët e Kosovës.

ASI: Çka do të përfitonin kosovarët nëse këto ide (praktikat estoneze) do të zbatoheshin në Kosovë?

GG: Një prej dobive dhe efekteve më të rëndësishme të implementimit të praktikave Estoneze në Kosovë është se do të ndihmohej në masë të madhe vendosja e rendit në qeverisje dhe administrim të vendit. Për qytetarët, kjo do të thoshte se administrimi i gjendjes së tyre civile, të pronave, të lëndëve gjyqësore, etj. do të bëhej i qartë, i sigurt dhe efikas. Qytetarët do të përfitonin drejtpërsëdrejti nga këto mundësi sepse do të kishin qasje të lehtë në dokumente administrative. Shumë prej obligimeve që u marrin qytetarëve ditë të tëra dhe mund të madh - me shërbime elektronike do të mund të kryeshin në vetëm disa minuta. P.sh.: përpilimi i një kërkesë do të behej pa u zhvendosur në zyrat përkatëse. Kjo është në veçanti e rëndësishme për qytetarët nga diaspora. Poashtu, kjo do të ndihmonte

jashtëzakonisht shumë në përmirësimin e sundimit të ligjit, sepse në kohë të sotme, mospërdorimi – efikas – i metodave moderne në qeverisje dhe administrim do të thotë praktikisht pamundësi të zbatimit të përpiktë të shumë ligjeve.

ASI: A ka bazë ligjore mbi të cilën mund të zbatohen këto ide?

GG: Ne diskutimet e shumta që i kemi pasur në Estoni, nikoqirët tanë, me shumë modesti, na kanë theksuar pandarë se vizioni dhe vendo-smëria për jetësimin e këtij vizioni kanë qenë vendimtarë në suksesin e Estonisë në këtë domen. Por, ne implementi-min konkret, infrastruktura ligjore përkatëse është parakusht. Ne në Kosovë nuk kemi baza ligjore të mjaftueshme për ngritjen dhe implementimin e shërbimeve elektronike (TIK). Ka disa dokumente në nivel qeveritar, një konventë mbi Krimin në Kibernetikë e KE e adoptuar në Kuvend të Kosovës, por kjo nuk paraqet as për së afërmi infrastrukturë të mjaftueshme. Vlerësohet se duhet së paku një vit për të prodhuar një infrastrukturë ligjore elementare të zbatueshme. Dhe puna në hartim dhe harmonizim të infrastrukturës ligjore është e vazhdueshme – posaçërisht kur Kosova do të fillojë të integrohet më intenzivisht në Evropë.

ASI: Cilët do të jenë hapat konkretë që ju, si Anëtar i Kuvendit, do të ndërmerri në

formësimin e një politike të TIK-ut për Kosovën?

GG: Si anëtar i Kuvendit të Kosovës, por edhe si një person me përvojë profesionale në TIK, do të mund të kontribuojë në implementimin e TIK në Kuvendin e Kosovës. P.sh.: në implementimin e TIK në punën e komisioneve funksionale. Kjo është sa i përket rolit të mundshëm në Kuvend – nëse një kërkesë e tillë do të më bëhej. Nga ana tjetër, si një prej hartuesve të politikave të TIK si pjesë e programit të PR ORA, mendoj se është momenti i përshtatshëm t'i përkushtohem riaktualizimit të këtyre politikave me një elan të ri. Prej kthimit nga vizita studimore në Estoni, jam definitivisht i bindur se qytetarëve të Kosovës do t'u sillte dobi të mëdha investimi në këtë domen. Një program i mirëfilltë do të sillte përmirësimë substanciale në jetën e qytetarëve të Kosovës. Duke marrë parasysh se zgjedhjet lokale dhe qendrore janë paralajmëruar për nëntor të këtij viti, mendoj se tani është koha e mire për të hartuar politika të mirëfillta të TIK dhe përreth TIK dhe formuar një ofertë moderne për qytetarët tonë në kuptim të ofertës së shërbimeve elektronike dhe zgjidhjes së shumë problemeve të tyre.

Ne fund, kisha dashur të shprehja në emrin tim personal dhe në emër të gjithë pjesëmarrësve, falënderimin e sinqertë Qeverisë Estoneze, përkatësisht, Ministrisë së Punëve të Jashtme, për këtë vizitë jashtëzakonisht të pasur në shpjegime, diskutime, përvoja dhe inkurajimin për reformat e pashmangshme në shoqërinë tonë.

*Artan Canhasi,
Misioni i OSBE-së në Kosovë*

Një mënyrë alternative për të përfunduar procesin e statusit të Kosovës

Fjala e Presidentit Fatmir Sejdiu në Kuvendin e Kosovës, mbajtur më 30 korrik 2007



Më lejoni që në emër të Ekspertit të Unitetit t'ju njoftoj shkurtimisht për zhvillimet kryesore që kanë të bëjnë me përcaktimin e statusit politik të Kosovës, si dhe me kahet kryesore që do t'i përcjellim bashkërisht për ta përfunduar sa më shpejt këtë proces të rëndësishëm dhe jetik për Kosovën.

Që nga marsi i këtij viti, kur Kuvendi i Kosovës mbështeti Propozimin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari, duke dhënë njëkohësisht zotimin e vet për zbatimin e tij në Kosovën e Pavarur, janë bërë zhvillime të shumta politike në skenën ndërkombëtare, të cilat kryesisht kanë qenë të fokusuar në këtë Propozim në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Po kështu, trajtimi i tij është bërë duke siguruar mbështetje edhe në nivelet e Bashkimit Evropian dhe në institucionet e tjera evropiane.

Duhet theksuar se ky Propozim, të cilin e kemi cilësuar si dokument të balancuar dhe i kompromiseve të mëdha që ka bërë Kosova, është rezultat i një procesi të gjatë dhe të mun-

dimshëm ndërkombëtar të negociatave të udhëhequr nga Presidenti Ahtisaari dhe ekipi i tij dhe që është mbështetur gjatë gjithë kohës nga vendet anëtare të Grupit të Kontaktit.

I proceduar si i tillë në Këshillin e Sigurimit, krahas mbështetjes që ka marrë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe mekanizmat e tjerë evropianë, ky dokument që nga momenti i procedimit në Këshillin e Sigurimit ka marrë edhe mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së z. Ban Ki Moon dhe të shumicës së vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit.

Për fat të keq, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme dhe jashtëzakonisht intensive të ShBA-ve dhe të vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit nga Bashkimi Evropian, që nëpërmjet rezolutave të bashkësponsoruara nga ato, ta përmbyllin këtë proces me miratimin e një rezolute të re që do ta mbështeste këtë propozim dhe njëkohësisht do ta hiqte nga fuqia Rezolutën 1244, për shkak të bllokimit të

vazhdueshëm me kërcënimin me veto nga ana e Federatës Ruse, pas pesë projekt-rezolutave, teksti përfundimtar nuk u hodh në votim.

Ekipi i Unitetit, duke i përcjellë me vëmendje gjithë këto zhvillime dhe duke shprehur shqetësimin e vet, të institucioneve dhe popullit të Kosovës për këto pengesa të pa-justifikueshme, gjatë gjithë këtyre muajve ka zhvilluar një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm diplomatik me qëllim të argumentimit dhe sigurimit të mbështetjes të gjitha vendet anëtare të KS-së për pavarësinë e Kosovës

Ndonëse në fillim vizita e paralajmëruar e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit në Kosovë është vështruar me qasje të ndryshme - në të shumtën edhe si një mundësi për ta shtyrë procesin, kjo vizitë përkundrazi ka nxjerrë në sipërfaqe realitetin e ndërtuar pozitiv në Kosovë; vizionin e saj politik për të ardhmen e të gjithë qytetarëve të saj, të shumicës dhe të pakicave, gatishmërinë e institucioneve dhe të popullit të Kosovës për të funksionuar si shtet sovran dhe i pavarur, por edhe paqëndrueshmërinë e status quo-së si pengesë themelore për zhvillimin dhe prosperitetin e përgjithshëm demokratik dhe ekonomik të Kosovës dhe të perspektivës së qytetarëve të saj. Me këtë rast duhet theksuar se qëndrimi pozitiv për Kosovën dhe për mbështetjen e Propozimit të Presidentit Ahtisaari, ka mbizotëruar te shumica dërmuese e vendeve anëtare të KS-së, pra

edhe tek ato vende që fillimisht kanë pasur hezitime. Përjashtim është Federata Ruse që ende vazhdon me qasjen e saj të ditur.

Ekipi i Unitetit gjatë kësaj periudhe dhe në veçanti pas propozimit të Presidentit francez Sarkozy në Samitin G8, i cili mbështeti idenë e vazhdimin të procesit me angazhimet e reja të palëve edhe për 120 ditë, duke e theksuar automatizmin e hyrjes në fuqi të Propozimit të Ahtisaarit dhe që si i tillë në variante të ndryshme është propozuar në projekt-rezolutat e KS-së, ka intensifikuar aktivitetin e tij sidomos në kontaktimin e vendeve anëtare të KS-së nga Bashkimi Evropian, si dhe me zyrtarët më të lartë të ShBA-ve.

Duke pasur parasysh qëndrimin e qartë të ShBA-ve, i thënë edhe nga niveli më i lartë shtetëror, nga Presidenti George W. Bush gjatë qëndrimit të tij në Romë, Tiranë dhe Sofje, si dhe qëndrimet e vendeve kyçe të BE-së në mbështetje të Propozimit të Ahtisaarit dhe Pavarësisë së mbikëqyrur për Kosovën, Ekipi i Unitetit ka marrë po kështu garancione në vazhdim për këtë mbështetje nga ShBA-të, Komisioneri për politikë të jashtme i Bashkimit Evropian, z. Solana dhe nga vendet kyçe të Bashkimit Evropian veç e veç.

Në të njëjtën kohë, duke parashikuar paperspektivën e kapërcimit të një rezolute që do të mbështeste Propozimin e Ahtisaarit në Këshillin e Sigurimit, këta faktorë kanë propozuar qasjen alternative me një proces të ri të angazhimeve për të siguruar mbështetjen e Propozimit të Ahtisaarit dhe njohjen e koordinuar të pavarësisë së Kosovës pas një angazhimi shtesë prej 120 ditëve.

Ekipi i Unitetit, duke i analizuar në thellësi të gjitha këto zhvillime dhe duke pasur respektin e thellë për qasjen serioze që kanë ShBA-të dhe vendet kyçe të BE-së, sidomos pas kontakteve kohëve të fundit edhe me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, z. Ban Ki Moon, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, z. Jap De Hup Shefer, z. Solana dhe z. Baroso nga Bashkimi Evropian, ministrat e jashtëm të Italisë, Gjermanisë, Francës dhe të Portugalisë, e cila tani ka presidencën e Bashkimit Evropian, sigurimet e vazhdueshme për mbështetje nga Britania e Madhe, si dhe bisedat e zhvilluara të Ekipit me Sekretaren e Shtetit të ShBA-ve, znj. Condoleeza Rice, Nënsekretarin z. Nikolas Bërn, Ndihmësekretarin z. Daniel Fried, Drejtorin politik për Evropën Juglindore, Rouzmari Di Karlo, emisarin special, Ambasadorin Frenk Wisner dhe Këshilltarin për Siguri Nacionale, Stiven Heidli, ka shprehur gatishmërinë e tij që të kontribuojë në këtë proces të ri të angazhimeve, pra në këtë qasje alternative për ta përmbyllur procesin me Pavarësimin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Duke përcjellë me vëmendje vështirësitë që ka hasur ky proces gjatë kësaj periudhe, Ekipi i Unitetit ka dhënë vizionin e tij të qartë se rruga më e mirë do të ishte nxjerrja e një rezolute që do të kishte mbështetjen nga KS-ja. Por, nëse ky proces do të shkojë drejt bllokimit dhe zhagjitjes së tij, kemi theksuar prerazi se Kosova nuk mund të mbetet peng i vazhdueshëm i bllokadave që pengojnë përfundimin e mbarë të këtij procesi, prandaj duhet kërkuar rrugë alternative që nënkupton edhe këtë përpjekje të vendeve që e kanë

mbështetur dhe mbështesin fuqishëm projektin Ahtisaari dhe vizionin tonë politik për të ardhmen e Kosovës e po kështu edhe marrjen e vendimeve kyçe nga ana e institucioneve të Kosovës, përkatësisht nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Duke pasur parasysh Rezolutën e Kuvendit të Kosovës lidhur me procesin e definimit të statusit politik të Kosovës, përkatësisht pavarësimin e saj, të vitit 2005, duhet theksuar në veçanti se:

1. Në këtë proces të angazhimeve shtesë në nivelin e Grupit të Kontaktit, përkatësisht në formatin që duhet të saktësohet këto ditë, Kosova ua ka bërë me dije të gjithë faktorëve relevantë ndërkombëtarë - dhe këtë e ritheksojmë edhe tani - se Pavarësia e Kosovës është e panegociueshme;
2. Integriteti territorial dhe funksional i Kosovës është i pacenueshëm - Kosova është unike dhe e pandarë;
3. Propozimi Gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisaari konsiderohet dokument i përfunduar dhe i mbyllur për ne dhe si i tillë as nuk mund të hapet e as nuk mund të negociohet. Këtë dokument jemi zotuar se do ta zbatojmë në plotësi.
4. Delegacioni i Kosovës, përkatësisht Ekipi i Unitetit, mendon se gjatë kësaj periudhe në konsultim me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare do të japë kontributin e vet maksimal në trajtimin e aspekteve të veçanta të temave që kanë të bëjnë me relacionet e ardhshme të Kosovës dhe të Serbisë si shtete të pavarura. Këto tema mund të jenë, bie fjala, përfundimi i procesit

që ka të bëjë me kthimin e të pagjeturve dhe zbardhjes së fatit të tyre; çështjet e të drejtave të pensionistëve dhe e realizimit të tyre nga ana e shtetasve të njërit vend dhe vendit tjetër; çështjet që kanë të bëjnë me suksesionin; çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes dhe liberalizimin e kufijve; krijimi i mundësive për kthim të qëndrueshëm të qytetarëve të Kosovës që gjenden në Serbi.

5. Ekipi i Unitetit konsideron se kjo do të jetë vonesa e fundit në këtë proces dhe se nuk do të pranojë shtyrje të tjera të afateve, të cilat si të tilla sjellin me vete rreziqe të veçanta, jo vetëm në komprometimin e procesit, por edhe në ngritjen e shqetësimeve dhe të tensioneve me pasojë të paparashikueshme.
6. Ekipi i Unitetit zotohet se gjithë këtë proces në vijim deri në përfundimin e tij, duke llogaritur edhe marrjen e vendimeve të rëndësishme në Kuvendin e Kosovës, pra shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, do ta bëjë në partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë me ShBA-të dhe Bashkimin Evropian.
7. Ekipi i Unitetit, gjatë kësaj kohe, bashkë me institucionet e tjera të Kosovës, do të angazhohet në përgatitjen e Kosovës dhe strukturës së saj kushtetuese, legjislativë dhe institucionale, në mënyrë që ta lehtësojmë kështu edhe rrugën tonë si shtet i pavarur dhe sovran drejt integritimit në Bashkimin Evropian, në mekanizmat dhe organizatat ndërkombëtare dhe në NATO.

Prandaj, besojmë që ky afat kohor prej 120 ditësh të përfundojë pa asnjë shtyrje.

Ju faleminderit!

Koha për të reflektuar

Veton Surroi u shkruan anëtarëve të Ekspertit të Unitetit rreth dilemave dhe për propozimet e tij për procesin e statusit

Të nderuar kolegë,

Me anë të kësaj letre dua të shkëmbej me ju disa mendime dhe t'ju ftoj në një reflektim dhe bashkërendim për periudhën e ardhshme.

Momenti i tanishëm, siç e theksova edhe gjatë takimin tonë me z. Fried, me datë 9 korrik 2007, karakterizohet me vdekjen e konceptit për arritjen e pavarësisë së Kosovës dhe lindjes së një qasjeje tjetër. Koncepti i vdekur është ai të cilin e kemi pasur deri më tani, ai i udhëhequr nga presidenti Ahtisaari.

Ky koncept kishte këtë një logjikë zinxhirore: ne do të hynim në një proces negociator, i cili rrjedhimisht do të prodhonte Paketën e Ahtisaarit dhe kështu mbi bazën e kësaj Pakete do të miratohej Rezoluta e re e KS të OKB-së, me të cilën krijohet mundësia apo propozohet një detyrim për legjitimitimin e pavarësisë së Kosovës.

Në muajin korrik është tashmë e qartë se kjo rrjedhë është braktisur nga Perëndimi, pas bllokimit të Rusisë. Tani, jemi në një gjendje ku formulimi që e përshkruan më së miri, ndonëse me brutalitetin e karikaturës, do të ishte ajo ku Perëndimi u thotë kosovarëve "mund të bëheni të pavarur, nëse me këtë pajtohen Rusia e Serbia". Për më tepër, me po atë ndjenje, kosovarëve u vjen porosia tjetër se bëhet kalimi në një koncept tjetër të arritjes së pavarësisë, pa pranuar dështimin e qartë të konceptit të parë, e as konsekuencat që rrjedhin nga ky dështim. Për mendimin tim, ne do të duhej



së paku të vlerësonim pasojat e procesit të ardhshëm negociator në rrugën e deritanishëm, si dhe për dështimin e tij.

Qartazi, pasoja e parë është zbehja e kredibilitetit tonë. Kemi përsëritur, pa ndonjë qasje kritike, e as distancë të tillë, fjalët që na janë thënë prej përfaqësuesve perëndimorë. Tash, kur ndërrohet kursi, qytetarët tonë i mbajnë në mend fjalët tona, jo ato të bashkësisë ndërkombëtare. Me besueshmëri të zbehur do të jetë gjithnjë e më vështirë të përfshihemi në fazat e ardhshme të procesit negociator.

Pasoja e dytë është humbja e kapacitetit për koncesion, gjegjësisht zvogëlimi i hapësirës, deri në minimum, për të zhvilluar negociata. Gjatë pro-

cesit të Vjenës na është kërkuar, që si çmim për pavarësi, të bëjmë koncesione në rregullimin e brendshëm, territorial dhe joterritorial, si dhe në të drejtat e minoriteteve, në veçanti të serbëve të Kosovës. Ne i kemi pranuar pothuaj të gjitha kërkesat, me pothuaj kurrfarë rezistence (ndonëse kemi pasur qasje të ndryshme në bisedat tona të brendshme).

Pasoja e tretë, rrjedhimisht, është dobësimi i pozitës negociatore. Siç e thash në takimin tonë me z. Fried, insistimi që të mbahen negociatat e reja ne na shndërron në palë të dobët, nga e cila do të kërkohej koncesionet. Kjo për arsye më të thjeshtë të mundshme, e ajo është se ne jemi pikërisht pala e interesuar për pavarësi, pra

edhe pala nga e cila mund të kërkohej diçka në këmbim të pavarësisë.

Kur kësaj pozite të dobët i bashkohet edhe konstatimi i mëhershëm se kemi humbur kapacitetin për koncesion (apo thënë në mënyrë më të duhur, kapacitetin për koncesion me të cilin ruhet funksionaliteti i Kosovës) atëherë del se pasoja e katërt është se procesi i mëtejshëm negociator mund të rrezikojë funksionalitetin e shtetit të ardhshëm të pavarur të Kosovës. Teoretikisht, në një fushë të ardhshme bisedimesh, ndaj Kosovës mund të shtrohen vetëm edhe dy kërkesa të reja: autonomia territoriale-politike e serbëve të Kosovës, nën administrim (të heshtur apo hapur) të Beogradit dhe/ose ndarja terri-

toriale e Kosovës, gjegjësisht pavarësimi i pjesës së Kosovës banuar me shumicë shqiptare të Kosovës.

Dhe, po të ndodhë një "aksident i këtille" me aprovimin e cilësdo prej koncesioneve, nuk do të flisim më për pavarësimin e Kosovës por për parimin e ri, atë të përputhjes së kufijve shtetëror me kufijtë etnik, së paku mes shtetit të shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit të serbëve të Kosovës. Ky parim, medoemos, do të duhej të nënkuptonte dhunë dhe zhvendosje popullsie.

Nuk do mend se në këtë gjendje jemi kryesisht për shkak të pozicionimit bllokues të Ruisë në Këshillin e Sigurimit. Megjithatë, ky pozicionim nuk na abstenon prej nevojës që të shohim me sy kritik punën e Ekipit të Unitetit.

Një analizë, qoftë edhe sipërfaqësore, kritike, do të tregonte, sipas mendimit tim, këto mangësi:

- Mbështetja jokritike në një partneritet me ndërmjetësit ndërkombëtarë. Për ne Ahtisaari e të tjerët qenë perceptuar si faktorë vendimmarrës për pavarësi, e jo si instrumente ndërmjetëse politike. Formulimi se "duhet të jeni gjeneroz, e si këmbim merrni pavarësinë" nuk funksionoi për arsyen e thjeshtë se vendimmarrja nuk ka qenë në duart e ndërmjetësve, siç nuk është zakonisht.

- Mungesa e formalizimit të kanaleve komunikuese: Gjatë tërë procesit të Vjenës ka munguar qartazi institucionalizimi i kanaleve diplomatike të komunikimit. Ka ekzistuar një improvizim, i cili ende ekziston, dhe është lehtë i dëshmuar

me mungesë alarmante të raportimit me shkrim të shumicës së anëtarëve të Ekipit të Unitetit.

Një mungesë e këtille e ka lënë Ekipin e Unitetit në mëshirën e interpretimeve personale të asaj se çfarë janë hapat diplomatik.

Gjithashtu, komunikimi i jo i institucionalizuar diplomatik ka krijuar mungesë kufiri mes asaj që do të duhej të ishte informatë vetëm për anëtarët e Ekipit të Unitetit dhe asaj që është e përshtatshme të jetë shkrim në një gazetë të Kosovës.

- Mungesa e iniciativës dhe autonomisë në vendimmarrje: Gjatë tërë procesit është shlyer distanca mes konsultimit të nevojshëm me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare dhe marrjes së urdhrave nga përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare.

Grupi i Unitetit nuk është spikatur me ndonjë iniciativë të veten. Dhe kur është bërë këmbëngulja për ndonjë iniciativë, siç është puna e flamurit, procedura ka vazhduar vetëm nën diktatin e zyrave të huaja.

Kalimi prej një koncepti të dështuar të arritjes së pavarësisë në konceptin tjetër është duke zhvilluar këto ditë. Koncepti i ri që është shfaqur paraqet shumë sfida.

Sfida e pare është se koncepti i ri ende është në përpunim e sipër. Karakteristikë e këtij koncepti është dekompozimi i Paketës së Ahtisaarit, dmth, përpjekja për vendosjen e pranisë së re ndërkombëtare ende pa u saktësuar statusi. Karakteristikë, rrjedhimisht, mund të jetë se operacionet e

parapara për periudhën 120 ditëshe tranzitore (p.sh decentralizimi) të vendosen tash. Karakteristikë, mund të jetë, rrjedhimisht edhe përpjekja për dy rezoluta, siç ju pata paralajmëruarën vjeshtë të vitit të kaluar. E para, me të cilën vendoset prania ndërkombëtare, dhe e dyta e cila përcakton statusin. Për të përmbledhur, sfida e parë është se ende nuk kemi të bëjmë me koncept të përmbledhur, dhe procesi i përcaktimit të politikave të reja Perëndimore nuk na përfshin ne si partner.

Duke qenë konsumatorë të politikave të reja, ne po vihemi para aktit të kryer. Dhe këtu kemi të bëjmë me sfidën e dytë: a do të krijojmë kontinuitet në sjelljen tonë prej fazës së mëhershme, asaj të Vjenës? Nëse po, nëse kalojmë me automatizëm prej një fazë në fazën tjetër pa analizë kritike të asaj që kaluam dhe asaj që na pret, sfida e ardhshme është se a mund të mbesin bashkë në Grupin e unitetit? Dhe, a mund të sjellim ndonjë dobi me praninë tonë?

Për më tepër, që të gjitha këto çështje do të dalin në sipërfaqe në kohë kur duhet të merret edhe vendimi për zgjedhjet lokale dhe parlamentare. Zgjedhjet vetvetiu do të shtrojnë sfidat e veta: ruajtjen e unitetit politik në vend, mundësinë që zgjedhjet të keqpërdoren për shtyrje të pavarësisë, mundësinë që zgjedhjet të mos fokusohen në çështjet funksionale të vendit, por të jenë garë për status...

Për të gjitha këto, mendoj se duhet të bisedojmë dhe të merremi vesh. Do të ishte mirë, që në drejtim të marrëveshjes të kërkojmë përgjigje, mes tjerash, edhe për këto pyetje:

- Çfarë duhet të jetë qëndrimi i Grupit të Unitetit ndaj kalimit në Planin B?

- A ekziston Plani autokton B, dhe nëse jo, çfarë do të mund të ishte?

- A ka Kosova dinamikë të veten, pra edhe afatizime, apo do të vazhdojmë të pranojmë ato që na imponohen?

- Çfarë duhet të jetë qëndrimi i Grupit të Unitetit lidhur me negociatat e propozuara?

Si mund të funksionalizohet puna brenda Grupit të Unitetit (sistemi i raportimit dhe i përgjegjësisë, formalizimi i kanalit diplomatik)

- Si mund të ruhet uniteti politik karshi statusit në kohën e fushatës zgjedhore dhe çfarë mund të jetë roli i Grupit të Unitetit?

Besoj që ndajmë bashkërisht brengën për gjendjen e tanishme dhe ndjenjën se për këto çështje duhet të bisedojmë e të marrim qëndrime para shkuarjes sonë të përbashkët në Uashington, te sekretarja Rice. Besoj që një qëndrim i përbashkët do të na ndihmojë gjithashtu edhe për përmbushjen e obligimit tonë llogaridhënës para Kuvendit të Kosovës dhe opinionit publik. Duke pritur përgjigjen tuaj dhe debatin tonë të përbashkët urgjent gjatë ditëve të ardhshme, pranoni përshëndetjen e mia të sinqerta.

Prishtinë, 12 korrik 2007

Veton Surroi është anëtar i Kuvendit të Kosovës për Partinë reformiste ORA, ai gjithashtu është anëtar i Ekipit të Unitetit

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2008: Info mbi Qarkoren Buxhetore dhe Sfidat

Intervistë me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave Z. Haki Shatri

Muaji tetor është koha kur Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të dorëzojë Projekt Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për aprovim nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë intervistë Z. Shatri përshkruan procesin e përgatitjes së buxhetit për vitin 2008 si dhe specifikat dhe sfidat që përmban ky proces.

ASI: A dallon procesi i sivjetshëm i përgatitjes së buxhetit nga ai i viteve të kaluara?

Haki Shatri: Në korniza të përgjithshme procesi i përgatitjes së buxhetit nuk ka dallime pasi procesi është i vendosur brenda procedurave moderne, por janë disa risi që përgatitjes kushtet më të mira në proces të hartimit të Buxhetit në krahasim me vitet e kaluara:

Buxheti është i bazuar në dokumentin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) e cila Kornizë ka dal nga Draft - Plani i Strategjisë Zhvillimore të Kosovës dhe draftin e Memorandumit mbi politikat ekonomike dhe fiskale apo të njohur me emrin "Letra e qëllimit të mirë". KASH në vete përmban kornizën makroekonomike dhe kufijtë e shpenzimeve për sektorët prioritar të Qeverisë, ndërsa 'Letra e qëllimit të mirë' përmban politikat e punësimit, shpenzimet operative dhe kapitale si dhe kufijtë agregat të shpenzimeve. Po ashtu Procesi Buxhetor këtë vit ka specifikat e veta dhe ka tre komponentë brenda veti:



- procesin e rregullt Buxhetor,
- procesin e transferimit të përgjegjësive nga Fuqitë Rezervë tek IPVQ-të, dhe
- koston e re për Statusin të Kosovës.

ASI: Si i vlerësoni dëgjimet buxhetore (qershor –gusht) me përfaqësuesit e Organizatave Buxhetore?

HSH: Dëgjimet Buxhetore këtë vit janë duke u zhvillu-

are sipas Orarit të paraparë në bazë të Qarkores Buxhetore 2008/02. Krahasuar me vitet paraprake, këtë vit dëgjimet buxhetore mbahen më herët (korrik – gusht) për shkak të përfitimit në kohë për trajtimin dhe analizën e kërkesave buxhetore së bashku me Organizatat buxhetore dhe aktorët pjesëmarrës në këto dëgjime buxhetore (Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Zyra për Çështje Fiskale dhe Komisioni për buxhet pranë Kuvendit të Kosovës). Dëgjimet janë një forum për organizatat buxhetore që të shpjegojnë kërkesat e tyre dhe tu përgjigjen pyetjeve duke u bazuar në kërkesën buxhetore për financim të programeve dhe projekteve të dorëzuar para dëgjimeve.

Organizatave buxhetore janë udhëhequr zakonisht nga Sekretarët e Përhershëm të Ministrive apo Drejtorët e Agjensioneve me stafin e tyre menaxherial.

Kërkesat e Organizatave buxhetore në shumë raste tejkalonin kufijtë buxhetor të dhënë më Qarkoren buxhetore 2008/02. Në bazë të konkluzioneve të dala nga dëgjimet pritet që Organizata buxhetore të cilat kërkesat i kanë mbi kufijtë buxhetor t'i rishikojnë dhe t'i kthejnë në kufijtë e dhënë buxhetor.

ASI: A do të ketë ndryshim kualitativ në Buxhetin për vitin e ardhshëm, në kuptimin e rritjes së investimeve kapitale dhe stimulimin e zhvillimit ekonomik?

SHH: Me vetë faktin se pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në strukturën e përgjithshme të Buxhetit për vitin 2008 do të ketë rritje, lë të kuptohet se kemi një ndryshim kualitativ të përgatitjes së vet buxhetit dhe krijim të parakushteve për një zhvillim më të mirë ekonomik. Qëllimi më kryesor i Qeverisë është të krijojë kushte që shpiejnë në "Rritjen e shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në dobi të të gjithë qytetarëve të Kosovës". Të gjitha prioritetet e Qeverisë duhet të ndiqen në një mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë me synim që Kosova të fillojë përgatitjet për të hyrë në BE. KASH-i dhe Buxheti i vitit 2008 do të japin një bazë për konferencën e donatorëve menjëherë pas zgjidhjes së pritit të statusit të Kosovës.

Ndryshim tjetër pozitiv është se përgatitja e projekteve kapitale është më kualitative dhe kërkesa jonë është që projektet të përgatiten për ekzekutim në tremujorin e dytë të vitit e jo siç ndodh tani në tremujorin e tretë apo të katërt të vitit. Kufiri i projektuar i shpenzimeve kapitale këtë vit është në rritje prej 264.3 milion euro (në vitin 2007 ishte 198.9 mil.) shpërndarë sipas prioriteteve të Qeverisë dhe strategjive sektoriale.

ASI: Zakonisht është vonuar dorëzimi i Projektligjit për buxhet në Kuvend. A do të dorëzohet projektligji për buxhet edhe këtë vit me vonesë?

SHH: Ministria për Ekonomi dhe Financa si dhe Qeveria e Kosovës sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive obligohet që gjer në fund të muajit tetor të dorëzojë Draft Buxhetin në Kuvendin e Kosovës.

Siç jeni ne dijeni për shkak të specifikave që ka Kosova, rrugëtimi i draft buxhetit është me i gjatë derisa të arrijë në Kuvendin e Kosovës, dhe këtu mund të ketë pasur vonesa të cilat këtë vit do të mundohemi t'i shkurtojmë dhe draft buxheti me kohë t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës.

ASI: Deputetet e Kuvendit të Kosovës e veçanërisht ata të opozitës ankohen shpesh se ministria nuk ka ofruar informacione të mjaftueshme në lidhje me projektligjin për buxhet, p.sh. vitin e kaluar ka munguar lista e projekteve kapitale të parashikuara për vitin 2007. Cili është komentimi i juaj lidhur me këtë çështje?

SHH: Ligji i Buxhetit i aprovuar për vitin 2007 përmban për herë të parë listën e detajuar me emër dhe shuma përkatëse të projekteve kapitale për organizatat e buxhetit qendror. Dokumentet buxhetore të përgatitura për Kuvendin e Kosovës në këtë vit do të përmbajnë:

- Projektligjin vjetor për ndarjet buxhetore,
- Tabelat e ndarjeve buxhetore,
- Informatat mbi kornizën makroekonomike,
- Listën e projekteve kapitale.

ASI: Si e komentoni suficitin e krijuar në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. A i atribuohet kjo menaxhimit të mirë të buxhetit apo mos realizimit të buxhetit të parashikuar?

SHH: Duke ditur se Qeveria e Kosovës nuk ka politika monetare dhe treg financiar të organizuar dhe ka në duart e veta vetëm politikat fiskale është plotësisht e kuptueshme

që përgatitja e buxhetit është bërë jashtëzakonisht në mënyrë konservative, kjo kërkesë ishte e përhershme edhe nga FMN-ja dhe IFN. Kjo politikë kërkon që rezervat qeveritare gjithsesi të mbulojnë shpenzimet buxhetore së paku për dy muajt e vitit të ri buxhetor dhe ndonjëherë sigurimin e mjeteve edhe për politikatat e reja apo të bartura tek Qeveria e Kosovës.

Në anën tjetër në krijimin e suficitëve buxhetore ka ndikuar edhe realizimi më i lartë i të hyrave në një anë që është pozitive dhe nënshpenzimet e organizatave buxhetore në anën tjetër që është anë negative e medaljes. Ky nënshpenzim tregon se nevojitet ngritje e vazhdueshme e stafit në planifikim dhe realizimin e buxhetit sepse është e natyrshe se suficitet e krijuara nga ky menaxhim jo i duhur shkaktojnë ngecje ekonomike dhe pengesa në zhvillim

ASI: Çka mund të bëjë MEF në mënyrë që të sigurohet se projektet kapitale të parapara me projektligjin për buxhet do të realizohen?

SHH: MEF-i në mënyrë që të mos ketë vonesa në procedurat e Tenderimit, ka bere alokimin e buxhetit të aprovuar për shpenzime kapitale sipas planit të rrjedhës së parasë nga vete OB.

Po ashtu është bërë shkurtimi i afatit të liferimit sipas Ligjit të ri mbi prokurim, si dhe është rekomanduare që të ketë kujdes për ato kontrata që janë një burimore. Programi i Investimeve Publike (PIP) - projekt i financuar nga BE është duke trajnuar stafin e agjensioneve tona për të përgatitur dhe ekzekutuar më mire projektet kapitale.

ASI: Kuvendi i Kosovës është ne Procesin e Ristrukturimit të administratës dhe ka planifikuar rritjen e numrit të personelit mbështetës, përderisa MEF insiston në zvogëlimin e numrit të shërbyesve civil. A do të merren parasysh këto kërkesa të Kuvendit të Kosovës?

SHH: MEF në qarkoren Buxhetore 2008/02 ka caktuar kufirin e punëtorëve sipas OB në bazë të pajtueshmërisë së FMN-së dhe Qeverisë së Kosovës, për shkurtim të numrit të punëtorëve për 3,000 pozita në tri vitet e ardhshme.

Në vitin 2008, Qeveria është dakorduar me FMN që shkurtimi të behet për 500 pozita të punës, në të cilën reduktim është e përfshirë edhe administrata e Kuvendit të Kosovës.

ASI: Cili është parashikimi i Ministrisë rreth lartësisë së Buxhetit për vitin 2008?

SHH: Për vitin fiskal 2008 është paraparë niveli i shpenzimeve në shumën prej 852 milion euro, prej tyre në:

**Paga dhe Mëditje
210.4 milion euro.**

**Mallra dhe shërbime
158.3 milion euro.**

**Transfere
181.0 milion euro.**

**Shpenzime Kapitale
264.3 milion euro.**

**Shpenzime pas Statusit
35.0 milion euro.**

**Rezerva
3.0 milion euro.**

Arben Kelmendi,
Instituti Demokratik Kombëtar
(NDI)

OSBE-ja publikon raportin e saj të pesëdhjetë mbi punën e Kuvendit

Floriana Shala, Monitoruese OSBE-ja në Kuvendin e Kosovës

Në nëntor të vitit 2002, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm kërkoi që OSBE-ja të themelojë një mekanizëm për të monitoruar shqyrtimet e Kuvendit të Kosovës në kuptimin e Kornizës Kushtetuese, Rregullat e Punës së Kuvendit, si dhe praktikat demokratike parlamentare. OSBE-ja ka filluar monitorimin e Kuvendit më 2 dhjetor 2002, si dhe deri në ditën e sotme, ka prodhuar 50 raporte të monitorimit analitik.

Synimet e mekanizmit të monitorimit janë të vëzhgojë punimet e Kuvendit në lidhje me, mes tjerash, praktikat parlamentare si përgatitja e agjendës dhe dokumenteve tjera, si dhe shpërndarjen e dokumenteve të tilla tek Anëtarët e Kuvendit, sigurimin e qasjes së barabartë dhe pjesëmarrjes në debatet e Kuvendit për gjithë anëtarët e Kuvendit, shqyrtimin dhe miratimin e legjislacionit, procesin e votimit,



mit, qasjes publike ndaj seanceve plenare të Kuvendit, si dhe qasjen publike ndaj informatave të në dispozicion mbi punimet e Kuvendit.

Kuvendi ka përgjegjësinë e sigurimit që procedurat dhe mënyra e punës së tij të jenë të drejta, përfshirëse dhe t'i japin mundësi të barabartë secilit Anëtar që të luajë rolin e vet me punën e tij/saj, si dhe që të sigurojë proces efektiv legjislativ. Raportet e moni-

torimit të OSBE-së vënë një theks të veçantë në funksionet e lartpërmendura të Kuvendit duke dhënë rekomandime, si ai më poshtë, me qëllim të përmirësimit e praktikës dhe procesit ligjvënës të Kuvendit.

Kuvendi ka funksion kyç në sigurimin e mbikëqyrjes së Qeverisë, të cilën e ndërmerr përmes sistemit të komisioneve, pyetjeve parlamentare dhe interpelancave. Pyetjet parlamentare, si instrument i mbikëqyrjes parlamentare, paraqesin një mekanizëm të rëndësishëm hetues i cili synon t'i ofrojë mundësinë Deputetëve të kërkojnë informata mbi çështjet me rëndësi publike dhe ta mbajnë Qeverinë përgjegjëse për veprimet e saj. Shqyrtimi i dispozitave mbi interpelancat dhe pyetjet parlamentare për përgjigje gojore në Rregulloren e Punës së Kuvendit në qershor të vitit 2006 ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme komunikimin mes Kuvendit dhe Qeverisë. Në shumë raste

megjithatë pyetjet e Deputetëve nuk kanë marrë përgjigjet me kohë, siç kërkohet me Rregulloren. Raportet e monitorimit të OSBE-së rregullisht vëzhgojnë zbatimin e pyetjeve parlamentare, interpelancave dhe raporteve të komisioneve si dhe ndikimin e tyre në përgjegjshmërinë e Qeverisë.

Me rregullin e ri 26.11, "nëse një pyetje nuk është përgjigjur brenda dy seanceve plenare, pyetja do të publikohet në buletin e Kuvendit". Megjithatë, buletini i Kuvendit të Kosovës nuk përmban pjesë për pyetje që i janë paraqitur qeverisë, si dhe vijimisht nuk janë publikuar ndonjë herë pyetjet e tilla të mbetura. Publikimi i pyetjeve që nuk kanë marrë përgjigje me kohë në buletin e Kuvendit do të mund të rritte përgjegjshmërinë e Qeverisë para Kuvendit.

Shih Raportin e 50-të të OSBE-së mbi monitorimin e Kuvendit, pjesa e quajtur "Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me verbale".

Komisionet e Kuvendit paraqitën rekomandimet e tyre ndaj projekt-ligjeve, të cilat ishin miratuar në leximin e dytë gjatë periudhës së raportimit, duke tejkuluar në mënyrë të konsiderueshme afatin e caktuar në Rregullin 35.6 (komisioni udhëheqës do t'i raportojë rekomandimet e saj në Kuvend jo më vonë se dy muaj pas leximit të parë të projekt-ligjit, përveç nëse nuk miratohet një shtyrje nga Kuvendi), pa pyetur Kuvendin për zgjatjen e afatit. Komisionet e Kuvendit duhet të marrin parasysh shpejtimin e projekt-ligjeve për t'i miratuar ato në kohë të duhur, siç kërkohet edhe me Rregulloren e Punës. Vonesat në shqyrtim dhe miratim të projekt-ligjeve që vijnë theksojnë nevojën për planifikim më të mirë të agjendës legjislative mes Kuvendit dhe Qeverisë.

Shih Raportin e 50-të të OSBE-së mbi monitorimin e Kuvendit, paragrafi i parë nën titullin "Procesi legjislativ".

<http://www.osce.org/kosovo/documents.html?lsi=true&limit=10&grp=346>

Përmes raporteve analitike dhe rekomandimeve, mekanizmi monitorues i OSBE-së synon të kontribuojë në zhvillimin e një praktike efektive dhe të respektuar demokratike të ligjvënies në Kuvend, gjë që përbën themelin për funksionimin e shoqërisë demokratike në Kosovë

Deputeti duhet të jetë deputet!?

Intervistë me Z. Sadudin Berisha – Zëvendëskryetar i parë i Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, me nën komisionet për Barazi Gjinore, Peticione, Kërkesa Publike dhe Persona të Zhdukur.

Më 18 korrik 2007, Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore, Peticione dhe Kërkesa Publike shqyrtoi dhe vendosi të procedoj me leximin e parë të projektligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve.

ASI: Çfarë ka bërë Komisioni juaj deri më tani, sa i përket ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit?

Nevoja për të pasur një ligj që do të definonte të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve është paraqitur që nga legjislatura e parë e Kuvendit të Kosovës. Ligj, ky i cili do të synonte ndërtimin e identitetit të deputetëve si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës dhe krahas kësaj edhe përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësi që kanë ndaj votuesve. Duke pasur parasysh këto çështje, Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka marrë iniciativën për hartimin e projektligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Komisioni i ka caktuar detyrë grupit punues për të përgatitur versionin e këtij projektligji duke i marrë parasysh standardet, kushtet, zhvillimet në Kosovë dhe modalitetet të cilat aktualisht vlejné dhe aplikohen në rajon. Një procedurë e tillë nënkupton, shqyrtimin dhe miratimin nga vetë deputetët. Në shikim të parë duket se ka konflikt interesash, por nuk ka mekanizëm tjetër që mund ta rregullojë këtë lëmi. Në fund, Kuvendi i Kosovës do të jetë ai, që do të shqyrtojë dhe miratojë

një ligj të tillë.

Komisioni dhe grupet punuese kanë shqyrtuar versione të ndryshme të zgjidhjes së kësaj çështjeje në regjion dhe kemi shqyrtuar opsionet, të cila janë zbatuar në Shqipëri, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mal të Zi, Kroaci dhe Slloveni. Së këndejmi, i kemi akomoduar të gjitha ato pjesë të këtyre ligjeve të cilat kemi vlerësuar se mund të zbatohen në këto rrethana, në ndërtimin e statusit të deputetit dhe në përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësi të tyre.

ASI: Cilat janë pikat kryesore të këtij projektligji, cilat lëmi ka për qëllim t'i rregullojë?

Projektligji mëton të rregullojë përgjithësisht çështjen e mandatit të deputetit, marrëdhëniet mes deputetëve dhe institucioneve qendrore dhe lokale të pushtetit dhe çështjen e të drejtave në kompensim.

Imuniteti do të varet shumë edhe nga vetë sistemi zgjedhor. Ai gjithashtu do të varet edhe nga ajo se çfarë niveli të imunitetit pretendon të ndërtojë Kuvendi i Kosovës, pra si subjekt i mëvetësishëm nga deputetët. Kujtoj se si është qasur në projektligj, në një mënyrë apo tjetrën, çështja e imunitetit duhet të jetë shumë më mirë e definuar se çka qenë deri më sot. Projektligji përcakton edhe të drejtën e heqjes së imunitetit dhe procedurat të cilat duhet respektuar me atë rast dhe në çfarë baza mund t'i merret deputetit imuniteti. Komisioni në versionin e fundit që ka miratuar ka pasur në diskutim edhe çështjen e mospërputhshmërisë së

funksionit me angazhimet e deputetit në institucionet publike dhe private, me ç'rast ka dhënë një version të zgjidhjes së kësaj çështjeje. Kjo çështje mbetet për tu diskutuar në procedim të mëtejme në strukturat e Kuvendit të Kosovës, nga Komisionet funksionale, buxhetore dhe nga vetë Kuvendi.

ASI: Në bazë të ligjit, a mund të bëhet një deputet ministër?

Ka pasur diskutime të shumta rreth asaj se a mund një deputet të bëhet ministër, apo të kryejë shërbime tjera në institucionet publike apo private. Pas shumë diskutimeve është menduar se deputeti duhet të jetë deputet dhe të mos ketë konflikte interesash me pozita tjera eventuale. Ky është një version që ka kaluar me shumicën e votave në Komision, por që në procedimin e mëtejme mund të ndodhë që kjo pjesë të rishikohet dhe të gjendet mënyra më e mirë e përcaktimit të së drejtës së deputetit eventualisht edhe në ushtrimin e funksioneve të tjera.

ASI: Si është e rregulluar pjesa e projektligjit që flet për kompetencimin, shpenzimet dhe përfitimet e tjera të deputetit?

Çështja e të drejtave në kompensim do të zgjidhet duke përcaktuar kritere të qarta që lidhen me ushtrimin e detyrës së deputetit.

Natyrisht, ky projektligj pretendon të rregullojë çështjen e së drejtës në pension, si e drejtë e cila u garantohet deputetëve sipas periudhës së kaluar kohore në funksionin e deputetit, me një, dy e më shumë mandate.

ASI: Cilat të drejta dhe obligime tjera të deputetëve janë të parapara në këtë projektligj?

Natyrisht, vetë fakti që kemi të bëjmë me të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, nënkupton që ato të drejta dhe përgjegjësi të jenë qartë të definuara. Përgjegjësia e parë e deputetit është të përfaqësojë interesat e qytetarëve, elektoratit që e zgjedh dhe e voton, që mbështet me projektin e tij/saj politik në periudhën mandatore katër vjeçare. Deputetët duhet të përfaqësojnë denjësisht interesat e qytetarëve dhe natyrisht të realizojnë projektet politike për të cilat është votuar – këto përbëjnë përgjegjësitë fundamentale dhe qenësore.

ASI: A keni diçka për të shtuar?

Një ligj i tillë kujtoj se ka qenë dhe është i domosdoshëm të procedohet dhe miratohet në Kuvend. Besoj se ky ligj do t'i kontribuoj përmirësimit të shkallës së përgjegjësisë së deputetëve në raport me funksionin e tij publik që e ka, në raport me qytetarin, në raport me subjektin politik që e përfaqëson dhe përgjithësisht në raport me interesat kombëtare të cilat i përfaqësojnë çdonjëri prej deputetëve në institucionin më të lartë përfaqësues të vendit.

Ky ligj nuk ka të bëjë vetëm me legjislaturën që aktualisht është në përfundim e sipër. Ky ligj ka për qëllim që legjislatura e tretë që do të dalë nga zgjedhjet demokratike, të ketë një bazë ligjore të përcaktuar, që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të mandatuar me votën e lirë të qytetarëve.

Artan Canhasi
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Nevojitet të tregohet pjekuri

Intervistë me Vesna Jovanović, deputete e Grupit Parlamentar SLKM-GIS.

ASI: Si e vlerësoni bashkëpunimin me anëtarët e partive politike shqiptare të Kosovës?

VJ: Zyrtarisht nuk ka ndonjë bashkëpunim, i vetmi bashkëpunim zhvillohet është ai në nivelin personal. Megjithatë, shumica prej nesh-anëtarët e listës serbe dhe anëtarët e partive politike shqiptare - njihen me njëri tjetrin për disa vite. Ky është mandati ynë i dytë, kështu që për sa i përket kësaj, ekziston bashkëpunim dhe marrëdhënie të mira. Ndonëse, në shumicën e rasteve kjo nuk shihet nga publiku.

ASI: A bashkëpunojnë me njëri tjetrin deputetët e partive minoritare?

VJ: Kam frikë se mund t'i irri-tojë disa deputetë të komuniteteve jo shqiptare dhe jo serbe, por këto janë faktet: më herët kur të gjithë ne ishim të involvuar në punën e Kuvendit, 99% e deputetëve të partive minoritare – i referohem turqve, boshnjakëve, ashkallive, egjiptianëve të Kosovës dhe të tjerëve- që votuan në mënyrë të njëjtë si shumica, pa marrë parasysh faktin që disa prej ligjeve nuk i përshtateshin nevojave të pakicave. Nëse ky ishte rezultat i presionit ose frikës është diçka që nuk mund ta gjykoj, por është fakt që pakicat (jo shqiptarët dhe jo serbët) në Kuvend votojnë si partitë shqiptare të Kosovës.

Kur flitet për mbivotimin, vijmë tek propozimi i Ahtisaarit dhe mekanizmi mbrojtës i supozuar për pakicat. Siç është dëshmuar nga përvoja,



deputetët e komuniteteve tjera votojnë si pjesa dërmuese e shqiptarëve në shumicën e rasteve, prandaj komuniteti serb kërkon që të përjashtohet nga ky mekanizëm: nëse përpiqemi t'i mbrojmë së bashku të drejtat tona së bashku me pakicat tjera (jo shqiptare dhe jo serbe), kam frikë që përsëri do të jemi pakicë në kuadër të pakicës, ngase interesat tona janë dukshëm më të ndryshme.

ASI: Meqë tanimë jemi duke biseduar për planin e Ahtisaarit, çka nënkupton dhe çka do të thotë kjo për komunitetin serb të Kosovës në rajonin e Gjilanit?

VJ: Shpresoj që po flasim për kohën, kur plani i Ahtisaarit do të shqyrtohet në mënyrë serioze dhe me shumë kujdes. Megjithatë, më duhet të them që ekzistojnë disa propozime praktike në këtë plan që mund të jenë të dobishme për komu-

nitetet, por kam frikë se nuk janë marrë parasysh mënyrat për implementimin e tyre. Pjesa dërmuese e popullatës beson që këto propozime janë lëshime të bëra ndaj komunitetit serb, gjë që nuk është e mirë. Ndonëse, ekziston një zonë e madhe e hirtë ndërmjet asaj çfarë është shkruar dhe implementimit të ardhshëm, që nuk ka gjasë të zbatohet në nivelin komunal. Kjo çështje ka të bëjë më së shumti me

“komunat e parashikuara të fshatrave” që ndodhen në zonat rurale. Atyre u mungon infrastruktura e duhur dhe njerëzit e përgjegjshëm, të cilët do të jenë në gjendje t’i menaxhojnë ato, ngase elita jonë kryesisht u largua në vitin 1999, ndonëse nuk po llogarisë pjesën veriore të Mitrovicës. Kam frikë që plani i Ahtisarit nuk e ka marrë parasysh gjendjen reale në Kosovë.

Për të filluar implementimin e propozimit të Ahtisarit në formën e tanishme do të nevojiten gjashtë muaj. IPVQ-të dhe komuniteti ndërkombëtar nuk kanë plan konkret për krijimin e komunës në rajon. Natyrisht, kjo do të jetë punë e Ministrisë së Pushtetit Lokal. Kujtoj se ka shumë ligje mbi reformën e vetëqeverisjes lokale. Me sa jam në dijeni, në këtë ministri janë duke u përgatitur shumë ligje për reformën e vetëqeverisjes lokale, ndonëse, përfaqësuesit e komunitetit serb nuk janë njohur me kontekstin e këtyre projekt ligjeve e as nuk kanë qenë të ftuar të paraqesin sugjerimet e tyre për hartimin e këtyre ligjeve. Praktika e qeverisë për përjashtimin tonë nga grupet punuese për hartimin e ligjeve vazhdon akoma. Reforma e pushtetit lokal është shumë e rëndësishme për ne dhe për këtë arsye duam të kemi ndonjë prej nesh në grupet punuese. Ndokush që nuk zgjidhet nga ministri, por që do të zgjidhet nga ne.

ASI: Çka do të thotë decentralizimi për qytetarët e Parteshit? Me këtë rast, çka do të fitonin qytetarët?

VJ: Ata menjëherë do të fitonin siguri psikologjike. Në fillim nuk do të kishte përfitim

material, por është e rëndësishme siguria psikologjike. Në dritën e negociatave, ku ekziston një paqartësi e shkallës së lartë në lidhje me çfarë do të ndodhë dhe çfarë do të bëhet më tutje, themelimi i komunës do të nënkuptonte njëfarë sigurie dhe shprese që serbët mund të organizojnë jetën e tyre. Ndonëse, e di që do të jetë vështirë të niset që nga fillimi. Së dyti, do të thotë që njerëzve nuk do t’u duhet më të shkojnë në Gjilan për t’i nxjerrë dokumentet e caktuara dhe për t’i bërë pagesat e ndryshme. Kjo nënkupton edhe reduktim të shpenzimeve. Gjithashtu, mendoj që komuniteti ndërkombëtar, Beogradi por edhe IPVQ-të do t’i përqendrojnë interesat e tyre në ne dhe kjo do të rezultojë me një investim të rëndësishëm. Kemi punuar dhe akoma jemi duke punuar në projektet për zhvillim, që sipas mendimit tim i kanë ndihmuar Parteshit të bëhet komunë. Kemi pranuar të bëhemi projekt pilot për të parë se si do të duket kjo dhe të mësojmë prej gabimeve tona dhe nëse ka patur ndonjë gabim nga Institucionet e Përkohshme, të nxirren në pah. Nuk kemi mundur të arrijmë marrëveshje me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe IPVQ-të dhe nuk ka ekzistuar mbështetje e duhur nga ana e UNMIK-ut. Për këtë proces kemi patur mbështetje të fortë prej të gjitha Zyrave Ndërlidhëse në Prishtinë, ndonëse, në fund IPVQ-të nuk kanë pranuar që Parteshi të bëhet zonë kompakte siç kemi kërkuar. Një hapësirë e vazhdueshme që do t’i mundësonte të gjitha lidhjet me objektet shkollore, shëndetësore dhe kulturore, një hapësirë që nuk do t’i

ndante familjet, një hapësirë që do të ishte e qëndrueshme.

ASI: Cilat do të ishin sfidat kryesore të implementimit të planit të decentralizimit?

VJ: Dikush është dashur të bënte planin konkret se si të përmirësohet p.sh. infrastruktura në komunat e ardhshme “serbe”. Pavarësisht nga fakti që nuk është arritur marrëveshja përfundimtare, në 70 përqind të rasteve dihet se ku do të krijohen komunat e reja, por duhet të ndiqet ky proces, madje edhe pa arritur marrëveshjen përfundimtare.

Gjithashtu, duhet të mendojmë për njerëzit që do ta udhëheqin procesin e themelimit të komunave në nivelin lokal. Tani, njerëzit të cilët janë në pushtetin lokal janë zgjedhur në vitin 2002 dhe mandati u ka kaluar shumë kohë më parë. A do të jenë ata akoma përgjegjës për procesin ose ndoshta do të ketë zgjedhje të reja në nëntor ose dhjetor? A do të marrim pjesë të gjithë ne e pastaj t’i kemi përfaqësuesit, të cilët do t’i themelojnë komunat? A do të jenë këta njerëz nga partitë apo kandidatë të pavarur? Këto janë disa prej pyetjeve që kërkojnë përgjigje.

OSBE-ja është duke punuar në krijimin e resurseve njerëzore më cilësore dhe duhet së paku të fillojë të mendojë se si dhe kush do ta realizoj këtë proces në nivelin lokal.

ASI: Përveç ngjarjeve që ndërlihen me statusin, në Kosovë do të ketë zgjedhje të reja. Cili është qëndrimi i SLKM-së për sa i përket zgjedhjeve të ardhshme dhe a do t’i ftoni votuesit për të votuar?

VJ: Siç e dini, SLKM-ja është

koalicion që përbëhet nga SDP, DP dhe SRM. Vetëm DP-ja prej këtyre të triave është tani në pushtet në Beograd. Me sa duket, do të na duhet të vendosim në nivel të partisë, megjithëse do të parapëlqejë që të vendoset në nivel të koalicionit ose edhe më mirë të merret vendim i përbashkët i të gjitha partive serbe që operojnë këtu dhe nëse e mundshme të votohet si koalicion më vite. Nëse kjo nuk është e mundur, qëndrimi i SDP-së është të votoj në zgjedhje, ato lokale dhe qendrore dhe besoj që të dy palë zgjedhjet duhet të mbahen në të njëjtën kohë.

ASI: A keni ndonjë porosi për lexuesit e revistës sonë?

VJ: Tani do të citojë kryetarin e SLKM-së për atë se çfarë të bëhet në momentin kur vendoset për statusin. Pa marrë parasysh se çfarë do të jetë vendimi për statusin, porosia është që njerëzit nuk duhet të vendosin asgjë atë ditë, as serbët e as shqiptarët. Që do të thotë se, nuk duhet ta ndjekim mentalitetin tonë ballkanas, dhe le t’i mos shprehim ndjenjat menjëherë por le të qëndrojmë në shtëpi me familjet tona dhe të përpiqemi për të menduar me kokë të kthjellët se çfarë të bëhet tutje. Besoj se kemi patur shumë raste, ne dhe komuniteti shqiptar t’i shprehim emocionet në kuptimin pozitiv dhe negativ dhe që tani ka ardhur koha të tregojmë pjekuri.

Intervistën zhvilloi

Mario Maglov,

Koordinator i Qendrave për Informim të Komunitetit, DPI-UNMIK në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë

Raporti i Zhvillimit Njerëzor – më afër njerëzve.

Nora Ahmetaj – UNDP Kosovë

Raporti i Zhvillimit Njerëzor (RZhNj) është raport i pavarur, njëkohësisht edhe publikim vjetor i mandatuar nga Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP). Çdo RZhNj paraqet të dhëna dhe analiza për vendosjen e agjendave, si dhe tërheq vëmendjen ndërkombëtare mbi çështjet dhe opsionet e politikave të cilat i vendosin njerëzit në qendër të strategjive të tyre në mënyrë që të përballohen sfidat e zhvillimeve të sotme – siç janë ato ekonomike, sociale, politike dhe kulturore.

Raportet Nacionale për Zhvillim Njerëzor (RNZhNj) në anën tjetër, orientojnë qasjen e Raportit Global për Zhvillim Njerëzor në nivel nacional, duke vendosur kështu zhvillimin njerëzor në krye të agjendës politike nacionale. RNZHNJ paraqet një mekanizëm për analizë të politikave i cili pasqyron prioritetet e njerëzve, përforon kapacitetet nacionale, angazhon partnerë në nivel nacional, identifikon pabarazitë si dhe bën matjen e progresit të arritur.

Raporti i parë i zhvillimit njerëzor në Kosovë është publikuar në vitin 2002. Ai është përqendruar në ndërtimin e Kosovës së pasluftës dhe masat për ngritjen e gatishmërisë së qytetarëve në kërkimin e llogaridhënies nga vendimmarrësit. Ky raport gjithashtu, për herë të parë, synon të bëjë llogaritjen e indikatorëve të zhvillimit të emëruar si Indeksi i Zhvillimit Njerëzor, Indeksi për Zhvil-



lime Gjimore dhe Indeksi për varfëri Njerëzore.

RZhNjK-ja e dytë, e publikuar në vitin 2004, iu qasë dhe i paraqiti shënime mbi zhvillimin njerëzor në nivelin komunal dhe Indeksin e parë të Pjesëmarrjes, i cili përshkroi nivelet e pjesëmarrjes civile dhe politike në të gjitha grupet etnike nga komuna si në vendbanimet urbane ashtu edhe në ato rurale në Kosovë.

Raporti i tretë, RZhNjK 2006, u përqendrua në rininë e

uruar RZhNj aktual i vitit 2006 për rininë.

Duke pasur parasysh që më tepër se gjysma e njerëzve në Kosovë janë nën moshën 25 vjeçare dhe diku rreth 21 përqind e kësaj popullate i përkasin moshës 15 dhe 25 vjeçare, sfidat e ndërlidhura me zhvillimin politik, ekonomik dhe social gjatë periudhës së tanishme tranzitore janë sfidat e para dhe kryesore të kosovarëve të rinj, të cilët përbëjnë punonjësit, biznesmenët, partnerët, qytetarët dhe udhëheqësit e ardhshëm të Kosovës.

Arsimi, punësimi, krijimi i familjes dhe ushtrimi i veprimtarive civile ishin disa nga komponentët kyçë të kësaj ankete të zhvilluar me rininë Kosovare, e cila mëton të bëjë vlerësimin e problemeve të tyre gjatë periudhës tranzitore nga fëmijëria e deri në moshën madhore me përgjegjësi sociale dhe role në shoqëri. Njëkohësisht, këto probleme janë analizuar edhe në kuadër të sfidave të tranzicionit me të cilat po ballafaqohet Kosova që nga ndërtimi i institucioneve demokratike, ekonomia e tregut të lirë, dhe çështjet siç është e ardhmja politike e padefinuar.

Kosovës vuri në theks problemet me të cilat pjesëtarët e këtij grupi të caktuar ballafaqohen që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999.

Për shkak se raporti i katërt i zhvillimit njerëzor në Kosovë i vitit 2007 është në përgatitje e sipër dhe mëton të sigurojë mundësi për të kuptuar nevojën e zhvillimit energjetik dhe ndërlidhjen në mes të dimensionit social dhe energjisë, ky raport do të përmend disa nga rekomandimet të cilat i ka sig-

Ky raport thekson që arsimi dhe punësimi janë dy komponentë të cilët më së shumti prekin gjysmën e popullatës në Kosovë – rininë. Pasi që popullata e arsimuar është jetike për çdo shoqëri pra me këtë edhe për zhvillimin social dhe ekonomik të saj, çështja e arsimit nuk duhet të konsid-

erohet vetëm si përgatitje e rinisë për tregun e punës, por duhet në vend të kësaj të vendoset si objektivi nacionalë ku do të përfshiheshin të gjithë.

Zyra e UNDP-së në Kosovë, ka mbajtur dy takime me deputetët e Kuvendit të Kosovës për të theksuar rëndësinë e rinisë dhe sjelljes së deputetëve më afër kësaj çështjeje e cila kërkon një shtjellim të hollësishëm dhe përpjekje shtesë nga të gjitha shtresat e qeverisë dhe shoqëria. Një nga takimet me komitetin parlamentar për arsim, kishte për synim theksimin e sfidave të sistemit arsimor, përderisa takimi tjetër i mbajtur më 27 qershor ishte një takim i përbashkët në mes të deputetëve dhe përfaqësuesve të të gjitha agjencive të OKB-së, të cilat paraqitën Objektivat Zhvillimore të Mileniumit dhe diskutuan për problemet e rinisë. Për më tepër, gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga RZhNj në Kosovë përfshinë kryesisht por jo vetëm komponentë të arsimit dhe punësimit.

Përmirësimi i sistemit të sigurimit të cilësisë, themelimi i një kornize nacionale të kualifikimeve e cila është e harmonizuar me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, rritja e konceptit të mësim-nxënies jashtë sistemit formal të arsimit, rritja e financimit të ndërlidhur drejtpërsëdrejti me ngritjen e kapaciteteve njerëzore janë vetëm disa nga rekomandimet e në lidhje me arsimin e rinisë në Kosovë, i cili duhet të arrihet me punë të përbashkët nga të gjithë akterët.

Pasi që rinia përbën shumicën dërmuese të njerëzve të cilët hyjnë në tregun e punës, dhe duke pasur parasysh mungesën e shkathtësive që posedojnë ata dhe mung-

esën e mundësive për punë, punësimi mbetet një problem tjetër thelbësor me të cilin ballafaqohet rinia kosovare.

Mbështetja për Planin e Veprimt për Rininë (2007-2010) dhe Planin e Veprimt për Punësimin e Rinisë në Kosovë, lehtësimi i vendimmarrjes në karrierë, shfrytëzimi i potencialit të ndërmarrësisë, ofrimi i kushteve më të favorshme për punësim në administratë publike, sigurimi i mundësive për arsim profesional dhe koordinimi i mbështetjes së donatorëve janë vetëm disa nga sugjerimet e RZhNjK-së të cilat duhet të merren me seriozitet, se pari nga qeveria e Kosovës. Të rinjtë e papunësuar në Kosovë shohin fare pak mundësi punësimi, dhe ata mendojnë që institucionet qendrore dhe lokale janë duke bërë fare pak për t'i ndihmuar ata në gjetjen e punës.

Të gjithë të rinjtë në Kosovë, të punësuar apo jo, besojnë që institucionet e Kosovës kanë nevojë për ta, por ata rregullisht zhgënjehen nga mundësitë që këto institucione iu ofrojnë atyre. Disa që janë më optimist besojnë që pengesat do të largohen me kohë. Ata që janë më pak optimist, e që përbëjnë shumicën nuk janë edhe aq të sigurt. Ata mendojnë se problemet aktuale të punësimit në Kosovë janë tipike për këtë vend, gjë që e bën migrimin për ta më joshës se kurrë; është brengosëse që 50% e të rinjve dëshirojnë të migrojnë jashtë Kosovës.

Në mënyrë që të mbahet 'truri' në Kosovë, të gjitha institucionet duhet të gjejnë strategji për përmirësimin e arsimit dhe rritjes së mundësive të punësimit për kosovarët e rinj. Sa më shpejtë që të bëhet kjo do të jetë më mirë.

Mirëseardhje për Carlo Binda, Drejtor i Institutit Kombëtar Demokratik -“NDI”



Carlo Binda arrin në NDI në Kosovë pas dy viteve të kaluara si Ekspert Parlamentar dhe Zëvendësdrejtor për programin e Institutit në Jemen. Para se të angazhohej në Institut, Binda ishte deleguar nga Qeveria e Saskaqevanit për të punuar si Menaxher i marrëdhënieve ndërqeveritare për Komisionin Mbretëror mbi të Ardhmen e kujdesit shëndetësor në Kanada. Në kohën kur ishte pranë qeverisë së provincës Kanadeze të Saskaqevanit, ai shërbeu si këshilltar i posaçëm i Kryeministrit. Ai gjithashtu zotëron përvojë në lëmin e fushatave zgjedhore dhe organizimin e partive në nivelet komunale, provinciale dhe kombëtare me Partinë e Re Demokratike. Gjatë kohës së tij në Jemen, Binda menaxhoi projektin e ndërtimit të kapaciteteve legislative në Parlamentin e Republikës së Jemenit. Ai, po ashtu, krijoi një kaptinë kombëtare të Organizatës globale të parlamentareve kundër korrupsionit në Jemen, zhvilloi rrjete të llogaridhënies dhe politika zhvillimore brenda vendit dhe rregullisht punoi me deputetë, akademikë dhe akterë politikë në Lindjen e Mesme. Bindës pritet që kësaj vere në Kosovë ti bashkëngjitet edhe familja e tij.

Franklin De Vrieze
OSBE Misioni në Kosovë

Deputetët e Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s

Dr. Ferid Agani, Partia e Drejtësisë



Angazhimi afat gjatë i institucioneve politike të Kosovës për t'u bërë pjesë e integritimeve Euro-Atlantike ka filluar të bëhet realitet. Të ftuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-s dhe mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Delegacioni i Kuvendit të Kosovës në përbërje të: Naim Maloku, (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës), Ferid Agani, (Partia e Drejtësisë) dhe Hysnija Beshković, (Koalicioni "Vakat") morën pjesë në Programin e 8-të të Parlamentarëve të Rinj, që është organizuar nga Asambleja Parlamentare prej 8 deri më 2 gusht 2007 në Bruksel të Belgjikës.

Në këtë program pjesëmarrës ishin parlamentarët e shtatë delegacioneve anëtare nga: Estonia, Latvia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovenia dhe Spanja, si dhe gjashtë delegacione shoqëruese nga: Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Moldavia, Serbia, Federata Ruse dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, një delegacion shoqërues mesdhetar nga Jordani, një përfaqësues i Parlamentit Europian (Nën komisioni për Siguri dhe Mbrojtje) si dhe në cilësi të mysafirit tri delegacione parlamentare: Kuvendi i Kosovës, Senati i Pakistanit dhe Asambleja Kombëtare e Afganistanit.

Ky program është organizuar dhe mbështetur me sukses nga Sekretariati Ndërkombëtar i Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Ky program pesë ditor ishte një mundësi e jashtëzakonshme ofruar parlamentarëve të Kosovës. Kemi patur rastin të shohim prezantime të ndryshme dhe të marrim pjesë në diskutime me udhëheqësitë më të lartë ushtarake dhe politike të NATO-s, të kryesuar nga Gjenerali John Craddock, Komandanti Suprem i Aleancës së NATO-s për Europë (shtabi ushtarak i NATO-s, SHAPE në Mons), dhe Jaap de Hoop Scheffer, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s (shtabi për çështje politike në Bruksel).

Temat kryesore të prezantimeve dhe të diskutimeve ishin:

- Roli i Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe struktura e saj organizative (komisionet, nën komisionet, grupet punuese, stafi administrativ),
- Mënyra në të cilën funksionon Asambleja, duke përfshirë këtu edhe çështjet financiare,
- Programet për partneritet dhe bashkëpunim: seminarët Rose-Roth si pjesë qendrore e punës së Asamblesë, Programi për Parlamentarët e Rinj, Forumi Parlamentar Transatlantik, Grupi Special Mesdhetar dhe Iniciativa e Stambollit për Bashkëpunim dedikuar kryesisht Lindjes së Mesme,
- Anëtarësia e Asamblesë, që përbëhet nga 26 delegacione anëtare dhe 16 delegacione shoqëruese;
- Roli politik dhe operacional i NATO-s,
- Marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë,

- Mbrojtja raketore,
- Politikat nukleare të NATO-s,
- Partneriteti për Paqe dhe Shtetet jo anëtare;
- Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Asistenca Parlamentare,
- Marrëdhëniet NATO – BE,
- Diplomacia publike e NATO-s.

Koha për bërjen e pyetjeve dhe komenteve ishte një mundësi për secilin vend për t'i paraqitur pikëpamjet e veçanta për çështjet përkatëse. Delegacioni i Kosovës ka shprehur vullnetin, motivimin dhe gatishmërinë e shoqërisë dhe institucioneve kosovare si partnere e barabartë dhe pjesë e aleancës së NATO-s, për të pranuar ndarjen e përgjegjësisë të tyre për paqe dhe stabilitet në rajon. Komentet dhe deklaratat e delegacionit tonë janë vlerësuar nga zyrtarët përkatës si konstruktive dhe që përbëjnë një kontribut produktiv për suksesin e Programit.

Me këtë rast, delegacioni i Kuvendit të Kosovës ka shprehur interesim të veçantë për pjesëmarrje në programin Rose-Roth si dhe për organizimin e njërit prej seminareve të këtij programi vitin e ardhshëm në Prishtinë. Veç kësaj, është shprehur interesim për organizimin e programeve trajnuese të veçanta për anëtarët e Komisionit të Kuvendit për Siguri. Që të dy këto iniciativa janë mirëpritur dhe mbështetur nga Simon Lunn, Sekretari i Përgjithshëm i Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe stafit të tij.

Një karakteristikë e rëndësishme e programit ishte vendosja e kontakteve me delegacionet pjesëmarrëse si bazë për marrëdhënie zyrtare në të ardhmen.

Pjesëmarrja e suksesshme në Programin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s ka treguar që Kosova është në rrugën, drejtë bërjes së një shteti të pavarur dhe sovran, fuqimisht të integruar në strukturat politike dhe ushtarake europereëndimore dhe veri-atlantike. Së këndejmi, gatishmëria dhe motivimi i NATO-s për integrimin e Kosovës në strukturat e saja, nuk vihet aspak në pyetje. Është e qartë që institucionet e Kosovës kanë treguar nivel të njëjtë të angazhimit si shtetet tjera. Tani varet nga komuniteti ndërkombëtar që të sigurojë sa më shpejtë që është e mundur, status politik të drejtë, të qëndrueshëm, të pavarur dhe sovran për Kosovën, duke i aktivizuar në këtë mënyrë resurset politike konstruktive dhe kreative brenda shoqërisë sonë. Së këndejmi, në të njëjtën kohë është paraqitur kërkesë nga institucionet e Kosovës për t'i përmbushur standardet e domosdoshme politike dhe ushtarake, në mënyrë që të bëhet anëtare e familjes prosperuese të NATO-s.

Ftesa miqësore për pjesëmarrje të barabartë të delegacionit tonë në të gjitha fushat e këtij programi meriton respekt të thellë, dhe me këtë rast mirënjohje të veçanta i dedikohen Sekretariatit Ndërkombëtar të Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe OSBE-së që mundësuan këtë vizitë.

Kuvendi i Kosovës- nga këndvështrimi i deputetëve

Rinor Beka, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI)

Me qëllim të identifikimit të dobësive institucionale dhe nevojave të deputetëve, si dhe përcaktimin e prioriteteve për këto nevoja, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) ka zhvilluar një hulumtim të gjerë përmes të cilit pasqyron përshtypjet dhe bindjet e deputetëve në lidhje me funksionimin e Kuvendit të Kosovës. Ky hulumtim është zhvilluar përmes intervistave të realizuara me 86 deputetë të Kuvendit të Kosovës, nga të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Të dhënat e nxjerra nga ky hulumtim, kanë rezultuar me përfundime interesante që identifikojnë çështjet prioritare të cilat duhet të adresohen në përpjekje për të përmirësuar efikasitetin e punës në Kuvend. Në vazhdim do të shpalosim disa nga çështjet kryesore që janë ngritur nga deputetët.

Si problem kryesor në funksionimin e mirëfilltë të Kuvendit të Kosovës, deputetët e shohin përkrahjen e pamjaftueshme të deputetëve duke përfshirë kushtet e punës, shërbimet e dobëta për deputetë, mungesën e hapësirës për punë, mungesën e asistentëve. Nga 86 deputetë të intervistuar 67 prej tyre kanë cekur domosdoshmërinë e krijimit të departamentit për analiza dhe këshilla ligjore. Deputetët kanë theksuar edhe nevojën për krijimin e sektorëve për analiza buxhetore-financiare dhe krijimin e një sektori për hulumtime legjislativë.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës mendojnë se ndryshimi



i sistemit zgjedhor është i domosdoshëm për rritjen e cilësisë së përfaqësimit në Kuvend. 65% e deputetëve të intervistuar janë deklaruar se përkrahin sistemin zgjedhor proporcional me lista të hapura, 21% janë deklaruar se përkrahin sistemin e kombinuar ose të pastër mazhoritar, ndërsa 14% nuk do ta ndryshojnë fare sistemin aktual. Deputetët theksojnë se ndryshimi i sistemit zgjedhor e rrit nevojën për komunikim të rregullt të deputetëve me zgjedhësit e tyre. 46% janë deklaruar se forma më e preferuar për komunikim të rregullt me qytetarë është përmes hapjes së zyrave të deputetëve në qytetet prej nga vijnë dhe kanë theksuar domosdoshmërinë e ndihmës financiare institucionale nga Kuvendi.

Në lidhje me kompetencat, mekanizmat dhe kapacitetin e Kuvendit të Kosovës për të ushtruar mbikëqyrje efektive

të punës së degës ekzekutive të pushtetit ekzistojnë bindje të ndryshme të deputetëve varësisht nga fraksioni politik të cilit i përkasin. Mbi 35% të deputetëve të intervistuar që kryesisht u takojnë partive në pushtet besojnë se Kuvendi i Kosovës ka kompetencat adekuate për mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe kapacitete të nevojshme për të realizuar atë. Nga 86 deputetët e intervistuar, 83 mendojnë se funksionalizimi i kohës për pyetje parlamentare dhe mekanizmat tjerë ka ndikuar në përmirësimin e kualitetit të mbikëqyrjes. Sidoqoftë, deputetët theksojnë se ende mbetin sfida të mëdha në forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit veçanërisht në ekzekutimin e buxhetit nga Qeveria.

Lidhur me sistemin aktual elektronik për menaxhim të dokumenteve, edhe pse shumë i lehtë për t'u shfrytëzuar, 43% e deputetëve kanë deklaruar se

kanë nevojë për trajnime shtesë ngaqë nuk dinë ta përdorin këtë sistem. 25% të deputetëve kanë theksuar se ky sistem nuk përmban informacione relevante andaj edhe nuk shfrytëzohet.

Transparenca në Kuvend

Hapja e Kuvendit të Kosovës ndaj qytetarëve dhe ndërtimi i marrëdhënieve të deputetëve me qytetarë gjithashtu është konsideruar nga si një nga prioritetet në të cilat duhet të punohet. 52%

e deputetëve janë deklaruar për "Ditën e Kuvendit" si ditë e caktuar kur Kuvendi hap dyert për vizita të qytetarëve, përderisa të tjerët kanë propozuar që të realizohen vizita të rregullta të nxënësve, studentëve apo qytetarëve thjeshtë si dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore në hapësirat e ndërtesës së Kuvendit.

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se adresimi i çështjeve të ngritura nga deputetët është i domosdoshëm për përmirësimin e efikasitetit të punës në Kuvend. Këto shqetësime të deputetëve duhet të merren parasysh veçanërisht tani, kur janë duke u bërë projeksionet për propozim buxhetin e Kuvendit të Kosovës për vitin 2008. Deputetët e Kuvendit kanë mirëpritur iniciativën për këtë hulumtim dhe kanë shprehur domosdoshmërinë e zhvillimit të hulumtimeve të ngjashme në baza periodike.

Forcimi i kapaciteteve për krijimin e një procesi sistematik dhe të koordinuar të hartimit legjislativ

Alfons B. Lentze, LLM, Projekt i financuar nga BE-ja 'Mbështetja e mëtutjeshme për Kuvendin'.

Jennifer Ober, Këshilltare e lartë në Kuvend, OSBE



Hartimi sistematik legjislativ çon kah bërja më mirë e ligjeve. Pra, bëhen ligje të cilat janë të qarta dhe nuk kanë dykuptimësi, janë koherente dhe të unifikuara. Këto tipare ofrojnë cilësi që mbështesin kornizën ligjore për të siguruar që qytetarët të janë të informuar për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre sipas ligjit dhe t'u lehtësojnë gjykatave që të marrin vendime mbi dispozitat e ligjit në vend të ushtrimit të kompetencave legjislative. Përderisa nuk ekziston një model i vetëm për hartim ligjor, ekzistojnë udhëzime të cilat mund të shfrytëzohen qoftë për ligjvënësin i cili është duke hartuar një ligj në Prishtinë, apo Bruksel e Uashington. Këto udhëzime përfshijnë teknikat e hartimit dhe parimet e hierarkisë së ligjeve, harmonizimin e ligjeve me kornizën ekzistuese ligjore dhe parimet e kodifikimit që mund të jenë bazë për një hartim sistematik dhe të koordinuar në mes të degëve të pushtetit shtetëror.

Konsolidimi i një qasjeje të hartimit ligjor është posaçërisht i rëndësishëm në Kosovë duke pasur parasysh rregullimin e saj të komplikuar ligjor përfshirë këtu OKB-në, UNMIK-un, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës; dhe nëse kësaj ia shtojmë edhe Kornizën Kushetuese dhe instrumentet specifike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me të cilat duhet të harmonizohet çdo ligj, është lehtë të shihet përse hartimi i ligjeve në Kosovë është i vështirë, konfuz dhe që merr kohë shumë. Vonesat dhe problemet gjatë fazës së hartimit kanë implikime gjatë tërë procesit legjislativ. Duke e përmirësuar procesin e hartimit të ligjeve mund të përmirësohet i tërë procesi legjislativ.

Nga 9-13 korriku 2007, projekti i financuar nga BE-ja "Mbështetja e mëtutjeshme ndaj Kuvendit të Kosovës", i udhëhequr nga Agjensioni Evropian për Rindërtim dhe Njësia për Kuv-

endin Qendror nga OSBE-ja kanë mbajtur një program trajnimi mbi "Udhëzimet për Hartim Ligjor." Synimi kryesor i këtij trajnimi ishte që të bëjë konsolidimin e kapaciteteve të qëndrueshme institucionale për hartimin e ligjeve në Kuvend. Ky trajnim kishte një synim specifik: që të fuqizojë kapacitetet profesionale dhe shkathtësitë teknike të Sektorit të Departamentit Ligjor në kuadër të Komisionit, brenda Sekretariatit të Kuvendit dhe të krijojë lidhje më të forta me Zyrën për mbështetje të shërbimeve ligjore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe me zyrtarët ligjor të ministrive. Përveç zyrtarëve nga këto institucione, në këto trajnime gjithashtu kanë marrë pjesë edhe asistentët e Komisionit nga NDI dhe OSBE të cilët i ndihmojnë Komisionet parlamentare për të shqyrtuar projektligjet. Ky trajnim është prezantuar nga Jenifer Ober nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Andrea Kerstges nga Bundestagu Gjerman dhe Alfons B. Lentze nga projekti i financuar nga BE-ja "Ndihma e mëtutjeshme për Kuvendin e Kosovës".

Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në një kurs treditëor i përbërë nga tri lëndë: mbështetja e Komisionit, hartimi ligjor teknik, dhe procesi i përafritimit me politikën e BE-së. Gjatë dy ditëve të fundit të kursit, pjesëmarrësit morën pjesë në këtë trajnim të specializuar gjatë së cilit ata është dashur të zgjedhin një projektligj ekzis-

tues dhe ta kalojnë atë nëpër të gjithë procesin legjislativ, duke filluar nga faza e politikave. Nga pjesëmarrësit u kërkua të respektojnë listën kontrolluese të SIGMA OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) një mekanizëm praktik për të gjithë akterët në procesin legjislativ. Lista kontrolluese, posaçërisht mbulon pyetjet që kanë të bëjnë me ligjin p.sh. a ekziston ndonjë politikë më e mirë alternative? – por gjithashtu trajton edhe çështjet organizative dhe të personelit së bashku me përafritimin e ligjit me të drejtën Evropiane (acquis communautaire).

Gjatë këtij trajnimi u bë më se e qartë që mund të arrihet një procedim më efikas dhe më efektiv i legjislacionit, përfshirë këtu legjislacionin me prioritet të vendosur nga Agjenda Legjislative e Qeverisë, legjislacionin e kërkuar nga Plani i Peprimit për Partneritet Evropian dhe agjenda legjislative e Pakos së Ahtisarit.

Konkludimet përfundimtare të nxjerra nga pjesëmarrësit përfshijnë: njohjen e faktit që Kuvendi dhe Qeveria jo vetëm që duhet të punojnë së bashku në mënyrë më të përafërt por, por edhe në fazën më të hershme të procesit legjislativ; më shpesh të diskutohen politikën alternative; opinionin publik përfshirë këtu shoqërinë civile duhet të kenë një kontribut të shtuar në procesin legjislativ; dhe në Kosovë duhet të themelohet një model i harmonizuar, kon-

sekuent i hartimit legjislativ, i bazuar në udhëzimet e BE-së.

Sëkondejmi, AER-i dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë do të mbështesin grupin punues teknik të akterëve të Qeverisë dhe Kuvendit për të hartuar një mori udhëzimesh të tilla. Organizimi i grupit punues teknik me zyrtarë nga Qeveria dhe Kuvendi është i nevojshëm për të siguruar procesin legjislativ. Ky grup punues duhet të hartojë një sërë masash legjislative, për përdorim nga të gjithë akterët kryesor në procesin legjislativ; duhet të krijojë një mekanizëm për të bërë verifikimin e vazhdueshëm dhe monitorimin e procedimit të legjislacionit; dhe duhet të krijojë një mekanizëm për të shqyrtuar ligjet dhe siguruar standardizimin e tyre dhe harmonizimin me kornizën ekzistuese ligjore. Grupi punues gjithashtu do të diskutojë mënyrat për të rritur shkëmbimin e hershëm të dokumenteve në mes të departamenteve ligjore brenda IPVQ-ve.

Si përfundim, IPVQ-të për çdo ditë ballafaqohen me gjithnjë e shumë kërkesa të ndërlydhura me hartimin e legjislacionit të nivelit të lartë, nga një sërë akterësh të cilët çdo ditë e më shumë kërkojnë afate më të shkurtra kohore. Sistematizimi i hartimit legjislativ do të shërbejë për konsolidimin e procesit legjislativ, gjë që do të çojë në shfrytëzim më efikas të burimeve; të mundësojë një proces legjislativ më të shpejtë dhe efektiv dhe ligje më të qarta, që nuk kanë dykuptimësi, janë koherente dhe ligje të unifikuara, të cilat janë më të lehta për t'u zbatuar dhe monitoruar. Ndërkohë që dobia për Qeverinë, gjyqësorin dhe qytetarët nuk duhet mbivlerësuar.

Përvoja ime për gjysmë viti në Kuvendin e Kosovës

Labiot Smakaj, Intern at the Parliamentary Group of Democratic Party of Kosovo (PG-PDK)



Për gjashtë muaj, që nga fillimi i shkurtit deri në fund të korrikut isha i angazhuar si praktikant në grupin parlamentar të PDK-së në Kuvendin e Kosovës. Kjo praktikë për mua ishte një përvojë personale dhe profesionale që më dhuroi dije, përvojë shtesë dhe angazhim direkt në disa lëmi si p.sh:

- Involvimin dhe vendosjen e kontakteve me deputetët e Kuvendit të Kosovës
- pjesëmarrja në takimet punuese të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës
- pjesëmarrja në hartimin, përcjelljen dhe protokollimin e shkresave në Kuvend
- pjesëmarrja si vëzhgues në seancat në Kuvendin e Kosovës.
- praktikën e komunikimit dhe zbatimit të rendit të brendshëm parlamentar

Për këtë përvojë shume të dobishme do të falënderoja OSBE-në, GP –PDK si dhe koleget e mi praktikantë, të cilët bashkëpunuan me mua dhe më mundësuar që gjatë kësaj periudhe të fitojë njohuri, përvojë dhe angazhim për jetën parlamentare të Kosovës.

Unë kam shumë çfarë të them për të gjitha fushat e lartpërmendura por, më duhet të theksojë vetëm përshtypjet kryesore.

Edhe pse Kuvendi i Kosovës është themeluar në vitin 2001 pas zgjedhjeve të para parlamentare të Kosovës, kjo periudhe sado e shkurtër ka treguar rezultate të mira në zhvillimin e jetës parlamentare në kuadër të sistemit juridik-politik dhe kushtetues aktual të Kosovës.

Përshtypje shumë e veçantë për mua është që arrita ta shohë zbatimin e praktikës parlamentare në vendit tim, p.sh. se

si funksionon Kuvendi, cilat janë rregullat e brendshme të tij, si ndahen dhe si funksionojnë Kryesia, grupet parlamentare, komisionet, si bëhet përcjellja e legjislacionit, kërkesat për interpelancë të ministrave të Qeverisë.

Në përvojën time dua të potencojë gjithashtu ndikimin e Kuvendit në kontrollin politik dhe parlamentar ndaj Qeverisë.

Ia vlen të theksohet se unë kam fituar njohuritë themelore për funksionimin e jetës parlamentare të Kosovës e cila do të më ndihmojë në karrierën time të ardhshme si jurist i ardhshëm i Kosovës. Kjo praktikë gjithashtu më ka ndihmuar që sadopak të kombinojë teorinë juridike parlamentare gjatë studimeve në Universitetin e Prishtinës.

Unë jam i bindur se përvoja e deritanishme përveç anës profesionale, më ka ndihmuar edhe në pjekurinë time për arsye se mjedisi parlamentar, rregullat e takimeve, rendi i diskutimeve në sallat e komisioneve parlamentare, kanë ndikuar thellë në sjelljet e mia për të respektuar rregullat themelore të jetës parlamentare dhe intelektuale.

Fare në fund, dua të shprehë dëshirën që programi për praktikantë i mbështetur nga OSBE-ja dhe Kuvendi i Kosovës të vazhdojë, sepse ndiejë që të gjithë koleget e mi që studiojnë drejtësinë kanë nevojë të përfitojnë nga kjo përvojë tejet me vlerë.



Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legjislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respekthin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevoajt në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregulltë i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Ramë Manaj, Skender Durmishi, Sven Lindholm, Alfons Lentze, Edmond Efendija, Krenar Loshi, Artan Canhasi, Franklin De Vrieze.

Redaktor: Anna Richards, Chris Cycmanick

Grafika dhe faqësja: Shpend Kada

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
http: //www.osce.org/ kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :

OSCE: 1, 4, 10, 12, 15, 19. NDI: 16 EAR: 18
UNDP: 14. Fisnik Dobreci/Express 4. Jetmir Idrizi/Express 8.